

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT

**LËNDA: Biologji dhe edukimi shëndetësor
(klasa e tetë)**

Tiranë, 2006

1. Të përgjithshme

Biologjia në klasën e tetë do të zhvillohet në 35 javë mësimore me nga dy orë në javë, gjithsej me 70 orë gjatë vitit shkollor, në të cilat përfshihen orët e teorisë, të ushtrimeve, punëve të laboratorit dhe orët në dispozicion për mësuesin.

Në dispozicion të mësuesit lihen 15% të orëve (10 orë) për të organizuar ekskursionet, vlerësimin e nxënësve ose për qëllime të tjera të vlerësuara të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Ky program është konceptuar në ndihmë të:

Hartuesve dhe botuesve të teksteve mësimore dhe materialeve ndihmëse të mësuesve; specialistëve të arsimit, prindërve etj.

Studimi i gjallesave në klasën e tetë përqendrohet në përdorimin e sistemeve të klasifikimit si mjet për të mësuar për larminë e madhe të llojeve dhe për të organizuar studimin e tyre. Kështu, mësimi i biologjisë në këtë klasë do të ndikojë në formimin e përgjithshëm intelektual të çdo nxënësi duke realizuar mënyrën shkencore të njohjes.

Programi i kësaj klase do të realizojë përdorimin e koncepteve shkencore në situata të jetës së përditshme, duke mundësuar që nxënësit të përftojnë sjellje për të bërë zgjedhje për një jetë të shëndetshme, në mënyrë të veçantë lidhur me rimarrjen e problemeve për parandalimin e SST-ve, HIV-in, SIDA-n dhe hepatitin B.

Gjithashtu programi do të shërbejë në krijimin e marrëdhënieve harmonike ndërmjet nxënësve dhe natyrës.

Edhe në këtë klasë, lënda e biologjisë luan rol të rëndësishëm në formimin shkencor dhe zhvillimin e personalitetit të nxënësve.

Në orën e mësimit të biologjisë nxënësit njihen me *rrugën e përfimit empirik* të njohurive dhe në bazë të rregullave të njohura mund të bëjnë parashikime. Procesi mësimor i orientuar drejt veprimit, ndihmon në përfitim të aftësive dhe të qëndrimeve, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha lëndët e shkencave natyrore. Nxënësit, në bazë të planifikimit dhe kryerjes së eksperimenteve, mësojnë të vëzhgojnë dhe të përshkruajnë qartë, të paraqesin dhe të interpretojnë saktë.

Në orën e mësimit të biologjisë nxënësit merren gjithnjë e më shumë me çështje që përmbajnë kërkesa që kërkojnë zbatim, që kërkojnë si kusht paraprak *të menduarit e përgjithshëm dhe logjik*, duke përdorur njohuritë bazë të biologjisë. Puna që bëhet me paraqitjen e niveleve të ndryshme të organizimit të së gjallës (organele, qeliza, inde, organe, organizma, popullimi, bashkësi jete, sisteme ekologjike dhe biosfera), nxisin të menduarit abstrakt dhe formojnë të menduarit logjik.

Mësimi i biologjisë transmeton njohuri orientuese, të cilat u mundësojnë nxënësve *pjesëmarrjen në komunikim dhe në procese vendimmarrëse*, të cilat u përkasin çështjeve biologjike, shëndetësore e mjedisore.

Lënda e biologjisë është shumë e rëndësishme për *imazhin e njeriut*. Nxënësit njihen me bazat e organizimit të çdo qenieje. Kjo çon në gatishmërinë për të pranuar veten dhe për të dhënë ndihmesë në mënyrë aktive në ruajtjen e shëndetit vetjak, si dhe në forcimin e respektit ndaj të tjerëve e të të gjitha qenieve të tjera të gjalla.

Lidhja e drejtpërdrejtë me bukurinë dhe shumëllojshmërinë e natyrës, si dhe njohja e botës së kafshëve e të bimëve në natyrë është me shumë vlerë për nxënësit. Kjo gjë përforcon jo vetëm kontaktin emocional me botën e kafshëve dhe të bimëve, por jep

edhe shtytje për një organizim racional të kohës së lirë dhe nxit e forcon lidhjen me vendlindjen dhe vendbanimin.

Nga veprimtaria për të njohur qeniet e gjalla dhe proceset jetësore në kompleksitetin e tyre dhe varësinë e ndërsjellët, rritet gatishmëria për të qenë largpamës në mbrojtjen e vazhdueshme të burimeve natyrore, duke rritur *përgjegjësinë për brezat që do të vinë*.

2. Synimi i lëndës

Lënda e biologjisë në klasën e tetë synon:

- të përshkruajë dhe të shpjegojë strukturën e funksionin e organizmave të gjallë, si dhe ndërveprimet brenda tyre dhe mjedisit.
- të vlerësojë si të dobishme dijet dhe përvojat vetjake për rritjen e respektit të nxënësve për natyrën dhe njeriun.
- të përfshijë nxënësit në veprime konkrete për mbrojtjen e vlerave të botës që na rrethon.
- të nxisë aftësimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për një jetë sa më të shëndetshme.

3. Linjat e nënlinjat e përmbajtjes

Programi i paraqitur në vijim është i konceptuar sipas linjave dhe nënlinjave të përmbajtjes:

3.1 Klasifikimi i gjallesave

3.2 Shumëllojshmëria e botës së gjallë

3.2.1 Viruset dhe monerët

3.2.2 Protistët dhe kërpudhat

3.2.3 Bimët

3.2.4 Në botën e jorruazorëve

3.2.5 Në botën e rruazorëve.

3.3. Historia e jetës në tokë

3.4. SIDA dhe shëndeti

4. Objektivat, konceptet dhe aftësitë kryesore sipas linjave dhe nënlinjave

Synimi i programit për klasën e tetë detajohet në objektiva për secilën linjë apo nënlinjë. Në përputhje me objektivat, përcaktohen edhe konceptet dhe aftësitë si vijon:

4.1 Klasifikimi i gjallesave

Objektivat

Nxënësit të jenë në gjendje:

- të argumentojnë pse karakteristikat e lidhura me pamjen fizike (p.sh., përmasa, forma, ngjyra, ndërtimi) ose sjellja nuk janë attribute për të klasifikuar gjallesat;
- të shpjegojnë mekanizmin e klasifikimit të sotëm modern të gjallesave;
- të përshkruajnë pesë mbretëritë, që përdoren zakonisht për klasifikimin e gjallesave, duke dhënë shembuj nga secila nga këto mbretëri për të vërtetuar larminë e madhe të gjallesave, p.sh., monerët, protistët, kërpudhat, bimët, kafshët;
- të argumentojnë shkaqet e biodiversitetit biologjik në natyrë, si dhe lidhjet e tij me sistemin natyror të klasifikimit;
- të praktikojnë metoda të ndryshme për klasifikimin e objekteve dhe të gjallesave:

Njohuritë dhe aftësitë kryesore

Metodat e klasifikimit në kohë, domosdoshmëria e klasifikimit të gjallesave, klasifikimi i sotëm shkencor dhe dobia e tij, pesë mbretëritë e gjallesave; shkaqet e biodiversitetit biologjik, si dhe rëndësia e ruajtjes së tij si kusht i mbijetesës së njeriut, klasifikimi i objekteve dhe gjallesave sipas një klasifikimi shkencor.

Përdorimi i një fjalori të përshtatshëm me terminologjinë e duhur shkencore dhe në përputhje me programin, për të përshkruar gjallesat (si p.sh. sistem klasifikimi, klasifikim shkencor, klasifikim modern, çelës përcaktimi lloje, mbretëri, monerët, protistët, kërpudhat, bimët, kafshët, biodiversitet biologjik, fosile, etj). Shfrytëzimi i metodave dhe teknikave klasifikuese të gjallesave për të studiuar jo vetëm ndërtimin ,por edhe për te bërë dallimet evolutive të këtyre gjallesave në ndërtimin e brendshëm dhe në vendin që ato zënë në natyrë.

4. 2 Shumëllojshmëria e botës së gjallë

4. 2 .1 Viruset dhe monerët

Objektivat

Nxënësit të jenë në gjendje:

- të shpjegojnë strukturën bazë të një virusi; riprodhimin dhe infektimin e njeriut prej tyre (viruset dhe sëmundjet);
- të radhisin karakteristikat e mbretërisë monera dhe të përshkruajnë strukturën dhe riprodhimin e qelizave bakteriale;
- të përshkruajnë si ushqehen bakteret dhe ndikimin e tyre në jetën e njeriut (bakteret e dobishme dhe bakteret patogjene, p.sh., që shkaktojnë sëmundje seksualisht të transmetueshme, si: gonorreja e sifilizi etj.);
- të tregojnë me fakte se shumë baktere nuk mund të shihen me sy të lirë, por me anën e përdorimit të mikroskopit;
- të diskutojnë për problemet e ruajtjes së shëndetit nga viruset dhe bakteret patogjene.

Njohuritë dhe aftësitë kryesore:

Viruset, ndërtimi dhe riprodhimi i tyre; viruset dhe sëmundjet; mbretëria monera, ndërtimi dhe riprodhimi i baktereve, të ushqyerit e baktereve (bakteret e dobishme, bakteret e dëmshme dhe shëndeti i njeriut .Përdorimi i mikroskopit për ti dalluar dhe emërtuar ato.

Përdorimi i një fjalori të përshtatshëm, duke përfshirë terminologjinë e duhur shkencore dhe në përputhje me programin, në përshkrimin dhe vëzhgimin e viruseve dhe të baktereve (p.sh., të përdorin terma, si: virus, baktere, parazitë, të dobishme, të dëmshme, qeliza eukariote, qeliza prokariote etj.). Ndërgjegjësimi përmes metodave praktike për kujdesin dhe ruajtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit ku ai jeton, nga viruset dhe bakteret që shkaktojnë sëmundje.

4.2.2 Protistët dhe Kërpudhat

Objektivat

Nxënësit të jenë në gjendje:

- të përshkruajnë karakteristikat kryesore të gjallesave të mbretërisë së protistëve (p.sh. janë të ndërtuara nga qeliza tipike eukariote, shumohen në mënyrë joseksuale, seksuale dhe me konjugim, janë jetërushqyese dhe vetushqyese, ndarja e tyre në protozoarë dhe alga);
- të krahasojnë karakteristikat e protistëve jetërushqyese me ato vetushqyese;
- të vëzhgojnë në laborator gjallesat njëqelizore (protistët) dhe kërpudhat;
- të krahasojnë kërpudhat me likenet dhe të diskutojnë për sëmundjet që shkaktohen nga kërpudhat dhe përdorimin e tyre nga njeriu në jetën e përditshme;
- të vëzhgojnë zhvillimin e myku i bukës;
- të diskutojnë për problemet e ruajtjes së shëndetit nga protozoarët dhe kërpudhat

Njohuritë dhe aftësitë kryesore

Mbretëria protista (protozoarët, protistë jetërushqyese, sëmundjet që shkaktohen nga protozoarët); algat, protistë vetushqyese; krahasimi i kërpudhave me likenet, edukim shëndetësor: njeriu dhe kërpudhat (sëmundjet dhe kërpudhat).

Përdorimi i një fjalori të përshtatshëm, duke përfshirë terminologjinë e duhur shkencore në përshkrimin dhe krahasimin e kërpudhave dhe protistëve (psh. shumim jo seksual, seksual, konjugim, jetërushqyese, vetushqyese, protozoarë (njëqelizorë), alga, kërpudha, likene. Vizatimi i skemave ose krijimi i maketeve të thjeshta për të formuar te nxënësit përfytyrime të sakta biologjike, duke realizuar më parë hetime praktike (përdorimi i mikroskopit) të zhvillimit të njëqelizorëve dhe kërpudhave (myku i bukës). Vlerësimi i problemeve që kanë të bëjnë me ruajtjen e shëndetit nga protozoarët dhe kërpudhat e dëmshme.

4.2.3 Bimët

Objektivat

Nxënësit të jenë në gjendje:

- të përshkruajnë tiparet karakteristike të bimëve (p.sh., bimët kanë kloroplaste, klorofil, vakuola, janë të veshura me mur qelizor të fortë etj.);
- të shpjegojnë veçoritë e tri grupeve të bimëve joenëzore, briofiteve;
- të analizojnë tiparet e bimëve enëzore pa farë;
- të shpjegojnë tiparet e bimëve me farë të zhveshur;
- të krahasojnë tiparet e bimëve me farë të zhveshur me ato me farë të veshur;
- të identifikojnë gjallesat duke përdorur çelësin e përcaktimit në përcaktimin e grupeve kryesore bimore;
- të koleksionojnë fara të bimëve të ndryshme.
- të diskutojnë për problemet e ruajtjes së shëndetit nga poleni i luleve.

Njohuritë dhe aftësitë kryesore

Karakteristikat dalluese të bimëve; grupimi i tyre; bimët joenëzore- briofitet, bimët enëzore pa farë (bimët e hershme enëzore dhe fieret); tiparet kryesore të bimëve me farë të zhveshur dhe përhapja e tyre; tiparet kryesore të bimëve me farë të veshur, shumëllojshmëria dhe klasifikimi i tyre; sëmundjet alergjike të njeriut nga poleni i luleve. Përdorimi i një fjalori të përshtatshëm duke përfshirë terminologjinë e duhur shkencore dhe në përputhje me programin, në përshkrimin e botës bimore (p.sh. duke përdorur

terma të tilla si bimë joenëzore, enëzore, bimë enëzore pa farë, farë e veshur, farë e zhveshur, çelës përcaktimi etj.) përmes hetimeve, eksplorimeve dhe vrojtimit.

Koleksionimi, sipas teknikave të caktuara, për bimët në tërësi ose për pjesë të veçanta të tyre. Përdorimi i këtyre rezultateve shoqëruar me vizatim, përshkrim me shkrim dhe gojë si nxitje e dëshirës për të njohur natyrën dhe për ta mbrojtur atë.

Vlerësimi i alergjive të ndryshme që shkaktojnë bimë të caktuara në shëndetin e njerëzve të caktuar (poleni i luleve).

4.2.4 Në botën e jorruazorëve

Objektivat

Nxënësit të jenë në gjendje:

- të përshkruajnë karakteristikat dhe strukturën e kafshëve (p.sh., vetushqyes, jetërushqyes, aftësia për të lëvizur, shumëqelizorë eukariotë, simetria bilaterale ose dyanësore dhe rrezore, nuk kanë mur qelizor si bimët; rruazorë, jorruazorë etj.);
- të përshkruajnë karakteristikat e llojeve të parruazorëve për të ilustruar diversitetin e tyre (p.sh., sfungjerë, celenteratë, krimba, molusqe, artropodë);
- të përshkruajnë karakteristikat e sfungjerëve (si: gjallesa jetërushqyese, me dy shtresa qelizash, riprodhimi i tyre) dhe të celenteratëve (si: kafshë të ngjashme me lulet, me simetri rrezore, me dy shtresa qelizash, disa bëjnë jetë sedentare, riprodhimi i tyre etj.);
- të vëzhgojnë mënyrat e lëvizjes së hidrës;
- të tregojnë karakteristikat dhe ndërtimin e krimbave të shtypur (me tri shtresa qelizash, krimbat e shtypur parazitë e joparazitë dhe sëmundjet që shkaktojnë ato te njeriu);
- të tregojnë karakteristikat dhe strukturën e krimbave të rumbullakët (ndërtimi i tyre, sëmundjet që shkaktojnë te njeriu),
- të shpjegojnë karakteristikat e krimbave unazorë (ndërtimi i brendshëm dhe i jashtëm, riprodhimi, roli i tyre në përmirësimin e cilësisë së tokës);
- të listojnë karakteristikat e kafshëve me trup të butë (butakët ose molusqet, ndërtimi i jashtëm dhe i brendshëm, klasifikimi i tyre në varësi të guaskës dhe këmbës, grupimi i tyre në tri klasa kryesore, molusqet dhe rreziku i tyre për shëndetin e njeriut);
- të përshkruajnë karakteristikat e përgjithshme të tipit të këmbënyjësuarve (artropoda, kafshë me këmbë të nyjësuar, sistemet e organeve);
- të listojnë karakteristikat e klasave kryesore të tipit të këmbënyjësuarve (sëmundjet që shkaktojnë këpushat dhe rriqrat te njeriu);
- të përshkruajnë karakteristikat kryesore të tipit të lëkurëgjemborëve (me lëkurë me gjemba, simetri rrezore, me skelet të brendshëm etj.);
- të vëzhgojnë në natyrë shumëllojshmërinë e kandrrave.
- të diskutojnë për problemet e ruajtjes së shëndetit nga krimbat parazitare, butakët dhe kandrrat.

Njohuritë dhe aftësitë kryesore

Karakteristikat dhe struktura e kafshëve; sfungjerët dhe celenteratët; krimbat e shtypur; krimbat e rrumbullakët dhe unazorë, kafshët me trup të butë si dhe klasifikimi i tyre, karakteristikat e përgjithshme si dhe sistemet e organeve të tipit të këmbënyjësuarve (artropoda), klasat kryesore të këmbënyjësuarve; kandrrat dhe shëndeti i njeriut; karakteristikat e përgjithshme të tipit të lëkurëgjemborëve.

Përdorimi i një fjalori të përshtatshëm, duke përfshirë terminologjinë e duhur shkencore dhe në përputhje me programin, në përshkrimin e botës së kafshëve jorruazore (p.sh., duke përdorur terma, si: rruazorë, jorruazorë; simetri rrethore, dyanësore, sfungjerë, celenteratë, krimba, këmbënyjësuar etj.). Përpilimi i të dhënave të mbledhura përmes hetimeve me qëllim ruajtjen e tyre, duke përdorur grafikë, tabela dhe grafikë me ngjyra të realizuara me dorë ose me kompjuter (p.sh të bëjnë një inventar të kafshëve jorruazore të gjetura në një zonë të caktuar). Vëzhgimi i mënyrës së lëvizjes së disa kafshëve jorruazore si mënyrë për të treguar zhvillimin e tyre. Vlerësimi i rëndësisë së higjienës dhe mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga krimbat parazitare, butakët dhe kandrrat.

4.2.5 Në botën e rruazorëve

Objektivat

Nxënësit të jenë në gjendje:

- të listojnë karakteristikat e përgjithshme të rruazorëve (prania e kordës, të çarat në faring, prania e gypit nervor; sistemet e organeve etj.);
- të krahasojnë përshtatjet e rruazorëve që kanë lidhje mes tyre, por që jetojnë në mjedise të ndryshme dhe të shpjegojnë këto ndryshime;
- të analizojnë karakteristikat e peshqve (si kafshë me gjak të ftohtë, me trupin të mbuluar me luspa etj., sistemet e qarkullimit të gjakut dhe të frymëmarrjes etj., peshqit kërcorë, peshqit kockorë);
- të diskutojnë për veçoritë e amfibëve (ujëtokësorëve) të përshtatur për jetën në tokë dhe në ujë, (kafshë me gjak të ftohtë, sistemet e qarkullimit të gjakut dhe të frymëmarrjes etj. dhe llojet e amfibëve);
- të shpjegojnë karakteristikat e zvarranikëve si gjallesa që lidhen me jetën në tokë, si dhe sistemet e qarkullimit të gjakut dhe të frymëmarrjes;
- të krahasojnë praktikisht skeletet e rruazorëve tokësorë me ato ujorë.
- të shpjegojnë veçoritë e strukturës së shpendëve (tre llojet e pendëve, shikimin e mprehtë, skeletin etj.), riprodhimi, pllenimi, qarkullimi i gjakut dhe i frymëmarrjes etj.;
- të diskutojnë për karakteristikat bazë të gjitarëve, klasifikimi në varësi të lindjes së të vegjëlve, si dhe riprodhimi dhe zhvillimi i të vegjëlve, të ushqyerit, sistemet e qarkullimit të gjakut dhe të frymëmarrjes;
- të diskutojnë për problemet e ruajtjes së shëndetit të njeriut në përputhje me ruajtjen e mjedisit dhe botës së gjallë në të cilin ai jeton.

Njohuritë dhe aftësitë kryesore

Karakteristikat e përgjithshme të rruazorëve; karakteristika të peshqve; amfibëve (ujëtokësorët), karakteristikat e tyre për jetën në ujë dhe në tokë, zvarranikët, shpendët që fluturojnë dhe që nuk fluturojnë, gjitarët. Përdorimi i një fjalori të përshtatshëm në përputhje me terminologjinë e duhur shkencore dhe kërkesave të programit në

përshkrimin e hetimeve, vëzhgimeve në përshkrimin e klasifikimit të ruazorëve. Shfrytëzimi i materialeve të ndryshme (tabela, grafikë, përshkrime, vizatime) për të krahasuar ruazorët e ndryshëm, me qëllim evidentimin e ndërlikimit të ndërtimit dhe funksionimit të trupit të tyre. Ndërtimi i maketeve apo modeleve të thjeshta prej letre, druri, kartoni, mase plastike plasteline ose mjete rrethore për të formuar te nxënësit parafytyrime të sakta të sistemeve biologjike (skema të qarkullimit të gjakut, frymëmarrjes, sistemit nervor, etj. Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese për ruajtjen e mjedisit dhe botës së gjallë në të cilën jetojmë.
Edukim shëndetësor: Helmimi nga gjarpërinjtë.
Edukim shëndetësor: Kafshët dhe stresi.

4.3 Historia e jetës në tokë

Objektivat

Nxënësit të jenë në gjendje:

- të diskutojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet te gjallesat duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara nga paleontologjia, p.sh., arkeopteriski dhe shpendët e sotëm;
- të përshkruajnë ndihmesën e shkencëtarëve dhe natyralistëve, të cilët gjithnjë e më shumë vërtetojnë larminë e gjallesave;
- të shpjegojnë rëndësinë e fosileve si dëshmi të shndërrimeve të botës së gjallë;
- të diskutojnë për faktorët e evolucionit të botës së gjallë (konkurrenca, përzgjedhja natyrore dhe artificiale);
- të shpjegojnë mekanizmat e prejardhjes së llojeve të reja;
- të diskutojnë rolin e Ç. Darvinit në zbulimin e teorisë së evolucionit.

Njohuritë dhe aftësitë kryesore

Fosilet si dëshmi e shndërrimeve të botës së gjallë, konkurrenca, përzgjedhja natyrore, artificiale; formimi i llojeve të reja nga izolimi i pjesshëm ose i plotë etj.; studimi i zogjve fringila të Galopagos; udhëtimi i Ç. Darvinit me anijen “Bigëll“.

Përdorimi i një fjalori të përshtatshëm, duke përfshirë terminologjinë e duhur shkencore në përputhje me kërkesat e programit në shndërrimin e botës së gjallë (p.sh., përdorimi i termave evolucion, fosile, përzgjedhje natyrore, artificiale, lloje të reja, izolimi i pjesshëm, izolim i plotë etj). Të renditurit e fakteve dhe njohurive të ndryshme të evolucionit. (vizita në muze, vende me vlera arkeologjike, etj. Shfrytëzimi i të dhënave të grumbulluara në mënyrë të vazhduar përmes medias së shkruar dhe asaj elektronike për përforsimin e historisë së ndryshueshme të jetës në tokë.

4.4 SIDA dhe shëndeti

Objektivat

Nxënësit të jenë të aftë:

- të diskutojnë rreth HIV-it dhe SIDA-s;
- të diskutojnë rreth hepatitit B dhe të njohin masat për t’u mbrojtur nga ky infeksion. ;
- të përcaktojnë se në cilat rrugë mund të tejçohet HIV/ SIDA, SST dhe hepatiti B, si dhe në cilat rrugë nuk mund të tejçohet HIV/ SIDA SST dhe hepatiti B;
- të vlerësojnë rëndësinë e seksit të mbrojtur;

- të klasifikojnë sjelljet që rrezikojnë për HIV-in;
- të vlerësojnë se të sëmurët me sida janë po aq socialë sa dhe njerëzit e shëndoshë;
- të diskutojnë se përgjigja në mënyrë të prerë ndaj trysnive për të kryer marrëdhënie seksuale pa mjete mbrojtëse, ndërgjegjësimi për marrjen e masave parandaluese për shtatzëninë e padëshiruar, HIV-SIDA SST dhe hepatitin B, përdorimi i saktë i prezervativit, shprehja e dashamirësisë dhe solidaritetit ndaj njerëzve seropozitivë ose të sëmurë me sida, janë sjelljet më efikase për të parandaluar infeksionin me HIV/SIDA.

Njohuritë dhe aftësitë kryesore

Infeksionet seksualisht të transmetueshme, HIV-i, SIDA dhe shenjat e saj, hepatiti B transmetimi i sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, klasifikimi i sjelljeve që rrezikojnë për HIV-in, metodat kontrceptive, qëndrimi ndaj një të sëmuri me SIDA. Ndërgjegjësimi i nxënësve për mënyrat e transmetimit të virusit HIV dhe si mund të parandalohet: Marrja e vendimeve të duhura për shmangien e këtij rreziku Qëndresë ndaj situatave nxitëse dhe inkurajuese për marrëdhënie të pambrojtura. Përdorimi gjithmonë i mjeteve mbrojtëse. Krijimi i raporteve miqësore dhe inkurajuese ndaj personave të sëmurë me HIV AIDS..

5. Shpërndarja e orëve

Në klasën e tetë të arsimit të detyruar 9-vjeçar, biologjia parashikohet të zhvillohet në 35 javë mësimore me 2 orë në javë.

35 javë x 2 orë/javë = 70 orë vjetore

Linjat dhe nënlinjat	Sasia e orëve
1. Klasifikimi i gjallesave	5 orë
2. Shumëllojshmëria e botës së gjallë	40 orë
2.1 Viruset dhe monerët	5 orë
2.2 Protistët dhe kërpudhat	6 orë
2.3 Bimët	8 orë
2.4 Në botën e jorruazorëve	10 orë
2.5 Në botën e rruazorëve	11 orë
3. Historia e jetës në tokë	5 orë
4. SIDA dhe shëndeti	10 orë
Orë të lira	10 orë (15% e programit)

Shënim

Orët e planifikuara për linjat e nënlinjat përfshijnë teorinë, punët praktike, përsëritjen, punët me projekte. Orët e lira lihen në dispozicion të mësuesve për ekskursionet të cilat të zhvillohen në jo më pak se tre orë si dhe për të vlerësuar nxënësit në ato tema apo kapituj ku të shihet e arsyeshme.

Orët e lira

Qëllimi i orëve të lira (rreth 15% e orëve totale) është për ti lënë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me kërkesat e programit zyrtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm, sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësuesit të lëndës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, Drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Për mbushjen e tyre me material mësimor mund të përdoren burime të ndryshme.

Grumbullimi i fakteve, shifrave e të dhënave të ndryshme historike, gjeografike, demografike, kulturore, industriale, bujqësore, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

Organizimi i ekskursioneve në natyrë për mbledhjen e farave të bimëve, kandrrave të ndryshme dhe krijimi me to i një koleksioni, organizimi i vizitave në qendra të ndryshme prodhimi të shoqëruara me vrojtme dhe të pasuara me detyra; në ferma, pulari, qendra të shtimit të peshkut, kopshtin botanik, kopshtin zoologjik, muzeun e shkencave të natyrës, në shërbim të një objekti të paracaktuar; organizimi i konkurseve brenda klasës edhe për një kapitull; lojëra të ndryshme zbatimëse me elementë që zhvillojnë të menduarin logjik dhe kritik; përforsimi i njohurive të shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxënësve ashtu edhe mësuesin, janë disa veprimtari rekomandues për rubrikën e orëve të lira.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve të lira mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët, (në formën e një projekti ose të një teme komplekse), disa orësh, që shfrytëzon lidhjet konceptuale ndërlëndore dhe aspektet kroskurrikulare. Nxënësve u jepet një detyrë e cila përfshin njohuri ndërlëndore, e cila i shërben arritjes së objektivave të programeve të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe varieteti i veprimtarive, duke ju gjetur vendin e duhur përgjatë vitit mësimor, është një element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të rubrikës të orëve të lira. Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar kryesisht për qëllime rutinë të cilat nuk sjellin risi të reja në kurrikulin shkollor.

6. Integrimi

Mësimi i biologjisë, gjatë përshkrimit të dukurive merr parasysh ligjet dhe metodat e fizikës, të kimisë dhe të matematikës. Bashkëveprimi i njohurive të këtyre lëndëve krijon për nxënësit kushtin paraprak për ndërtimin e një imazhi racional të botës të bazuar në shkencat natyrore.

Në kuadër të projekteve të ndryshme, krijohet mundësia e një bashkëpunimi të mirë ndërmjet biologjisë dhe lëndëve shoqërore, veçanërisht në fushat e edukimit seksual, të të ushqyerit të shëndetshëm, edukimi për HIV/AIDS, parandalimin e drogës, të duhanit, alkoolit, të edukimit mjedisor etj. Përveç kësaj, mësimi i biologjisë transmeton njohuri të cilat përdoren edhe në lëndën e gjeografisë gjatë trajtimit të aspekteve natyrore, ekonomike apo shoqërore.

Pasuria e magjishme e formave të natyrës është një burim i rëndësishëm për shpalosjen e fantazisë dhe të krijimit edhe në fushën e artit, duke dhënë kështu një ndihmesë më vlerë në formimin estetik të nxënësve përmes muzikës, pikturës, veprimtarive artistike etj. Në lëndën biologji dhe edukim shëndetësor nxënësit marrin njohuri dhe zhvillojnë shkathësi dhe shprehi, përgjegjësi, qëndrime dhe vlera të cilat trajtohen dhe përdoren edhe në lëndë të tjera. Shumë vëzhgime, hulumtime, krahasime apo zgjidhje problemesh mund të realizohen duke pasur parasysh objektivat e lëndëve të tjera shkencore ose shoqërore.

Biologjia dhe kroskurrikula

Në kuadër të projekteve të ndryshme, krijohet mundësia e një bashkëpunimi të mirë ndërmjet biologjisë dhe lëndëve shoqërore, veçanërisht në fushat e edukimit, mjedisor, të të ushqyerit të shëndetshëm, edukimit për HIV dhe AIDS, SST, hepatitit B si dhe gjetjes së mënyrave për të shprehur dashamirësi dhe solidaritet ndaj njerëzve seropozitivë. Nxënësit në këtë mënyrë ndihmohen në edukimin e plote të tyre dhe bashkëkohor. Gjithashtu krijohen shanset për një brez të suksesshëm për jetën.

7. Metodologjia e zbatimit të programit.

Në mënyrë që lënda e biologjisë në shkollë të trajtohet me baza shkencore dhe konceptuale, që t'i largohemi deri në një farë mase karakterit përshkrues, të tregohet kujdes që të rritet pjesëmarrja aktive e nxënësve në veprimtarinë praktike.

Është roli i pazëvendësueshëm i mësuesit, i cili me anë të metodave interaktive (ku në qendër të orës së mësimi është nxënësi) vë në lëvizje dhe shfrytëzon potencialin intelektual të nxënësve, i pajis ata me aftësinë e nevojshme për një punë të pavarur dhe krijuese dhe në të njëjtën kohë i aktivizon ata me punë të tilla.

Nxitja dhe aktivizimi

Nxitja dhe aktivizimi i veprimtarisë njohëse të pavarur dhe krijuese të nxënësve në mësimin e biologjisë varet nga format, metodat, strategjitë dhe teknikat e të mësuarit, të cilat duhet të jenë të larmishme. Këto të fundit, nxisin aftësinë vëzhguese në natyrë, zhvillojnë të menduarin aktiv, pajisin nxënësin me shprehi të punës së pavarur, zhvillojnë të folurin me terminologjinë e duhur shkencore dhe ngjallin kuriozitet e respekt për natyrën që na rrethon .

Shpjegimi,

Shpjegimi, si metodë me mundësi tepër të gjerë përdorimi, zbatohet gjerësisht në të gjitha ato veprimtari, ku synohet të kuptuarit e thelbit, të shkakut, si rrjedhojë të formimit të koncepteve të sakta e të qëndrueshme për to. Sot synohet që me anë të shpjegimit mësuesi të tërheqë nxënësit duke organizuar një shpjegim aktiv, bashkëkohor dhe të motivuar.

Biseda

Biseda është një metodë potenciale. Ajo i ndihmon nxënësit të mendojnë, të krahasojnë, u nxit atyre pavarësinë dhe i ndihmon të vendosin marrëdhënie bashkëpunimi të

ndërsjella. Kjo metodë do të ishte më e frytshme në ato tema ku nxënësit kanë njohuri paraprake, të cilat i kanë fituar nëpërmjet rrugëve të shumta të informacionit masiv e mediatik.

Shumë të rëndësishme në mësimin e biologjisë janë përdorimi i demonstrimeve, ekskursionit, vëzhgimit dhe eksperimentit, të ushtrimeve, problemave etj.

Ekskursioni

Ekskursioni mësimor është një nga metodat më të frytshme për përvetësimin aktiv të njohurive teorike. Ai jep mundësi të mëdha për rritjen e shkallës së pjesëmarrjes së nxënësve në mësim, në gjallërimin e veprimtarisë së tyre, si dhe në rritjen e aftësisë mendore aktive e krijuese.

Nëpërmjet ekskursioneve mësimore nxënësit njihen më shumë me krahinën e tyre. Duke njohur natyrën dhe botën e gjallë, ata vlerësojnë më mirë pasuritë e saj dhe ndërgjegjësohen për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. Zakonisht, përmes ekskursioneve në një terren të caktuar, mësuesi këmbëngul që nxënësit të dallojnë një shoqërim apo grupim të caktuar gjallesash, të dallojnë thelbësoren nga jothelbësorja në dukuritë e botës bimore dhe shtazore, të zbulojnë marrëdhëniet e brendshme dhe lidhjet e varësisë së ndërsjellët ndërmjet vetë gjallesave e mjedisit ku jetojnë; të mbajnë qëndrim vëzhgues, deduktues ndaj natyrës, të orientohen drejt në një habitat të caktuar etj.

Demonstrimi.

Vend të rëndësishëm në mësimdhënien e lëndës së biologjisë zë demonstrimi. Nëpërmjet tij realizohet me mjete statike dhe dinamike paraqitja e sendeve, dukurive ose proceseve konkrete. Mjetet apo tabelat statike që kanë vlera shkencore e metodike, janë ato që paraqesin zhvillimin e botës bimore e shtazore, diagramet e luleve, herbaret me karakter përgjithësues, ekzemplarët (zakonisht në preparate të thata ose likuide) të të gjitha grupeve të kafshëve, duke filluar nga parruazorët e deri te rruazorët, preparatet likuide për ndërtimin e brendshëm të kafshëve ose ciklin e tyre të zhvillimit etj.

Tashmë në mësimet e biologjisë është krijuar një traditë që në vend të preparateve likuide të kafshëve përdoren disqe (CD) me materiale didaktike. E rëndësishme është që mësuesi të përdorë më shumë mjetet dinamike, pasi ato krijojnë mundësi për të demonstruar dukuri në lidhje me marrëdhënien e ndërsjellët funksionale të mjeteve, të cilat përbëjnë thelbin e parimeve, të proceseve ose ligjësisë që studiohen, gjë që nuk mund të arrihet nëpërmjet demonstrimit me anë të mjeteve statike.

Vëzhgimi dhe eksperimenti.

Shumë e rëndësishme në lëndën e biologjisë është realizimi i veprimtarisë vëzhguese eksperimentuese. Gjatë kësaj veprimtarie synohet që, nëpërmjet veprimtarive praktike, nxënësi të nxitet për të vëzhguar e për të mbledhur të dhëna për interpretimin e këtyre të dhënave dhe nxjerrjen e përfundimeve. Eksperimenti luan rol të rëndësishëm në mësimdhënien, pasi ai shërben si burim njohurish për përforcimin e njohurive si dhe për zbatimin e tyre në jetën e përditshme.

Ushtrimet dhe problemat.

Zgjidhja e ushtrimeve dhe e problemave aktivizon në shkallë optimale veprimtarinë njohëse të nxënësve, duke bërë atë, që nxënësit të arrijnë të mendojnë në mënyrë të pavarur, të mbrojnë dhe të argumentojnë mendimet e tyre.

Ushtrimet dhe problemat në lëndën e biologjisë, si forma të përshtatshme të punës së pavarur të nxënësve, shtrojnë para tyre kuptimin me ndërgjegje të detyrës për njohje. Këto detyra kërkojnë pavarësi nga ana e tyre për t'u zgjidhur dhe mësuesi mund t'i japë në formën e detyrave të shtëpisë ose si detyrë individuale gjatë punës në klasë, ku përgjigjet mund të jepen me gojë ose me shkrim, duke punuar edhe me tekstin (p.sh., ushtrimet që kërkojnë zërthimin e termave të fjalorit, ushtrimet që kërkojnë shpjegimin e grafikëve etj.).

Mjet i rëndësishëm për krijimin e një mjedisi që nxit të menduarit është futja dhe përdorimi i strategjive dhe i metodave të nxënësve në bashkëpunim mes nxënësve. Të nxënësve në bashkëpunim ndodh kur nxënësit punojnë së bashku, ndonjëherë dy e nga dy e ndonjëherë në grupe për të ngritur një problem të përbashkët, për të eksploruar një temë të përbashkët ose për të ndërtuar mirëkuptime reciproke në krijimin e ideve të reja. Mësuesi me mjaft sukses mund të realizojë në orën e mësimit punën me grupe, lojën me role, nxitjen e mendimeve apo të ideve (brainstorming, kubimin, tabelën e koncepteve, diagramin e Venit, etj.).

Nxënësit që punojnë së bashku në një grup të vogël për një diskutim, mund të mësojnë më shpejt, më me shumë saktësi se nxënësit që punojnë me metoda tradicionale. Por nuk duhet harruar se puna në grupe duhet ndërthurur me metodën e shpjegimit, e cila siguron dhënien e informacionit aq të domosdoshëm për të diskutuar në punën në grup.

Vizatimi.

Vizatimi është një formë pune mjaft e frytshme për ta bërë të menduarit të dukshëm. Nxënësit me shumë kënaqësi riprojektojnë trupin njerëzor, bimën, organe të ndryshme si dhe lidhjet që vendoset midis këtyre të fundit, etj.

8. Vlerësimi

Vlerësimi është një nga momentet më delikate të orës së mësimit dhe kërkon vëmendje. Matja e arritjeve dhe vlerësimi janë pjesë përbërëse dhe jetësore të mësimit në shkollat bashkëkohore.

Vlerësimi i nivelit të arritjes së objektivave lëndorë nga nxënësit është një element i rëndësishëm i procesit të mësimit të biologjisë pasi nëpërmjet përvetësimit të njohurive të mara nëpërmjet saj synohet edhe edukimi global i tij.

Format dhe teknikat e vlerësimit mund të jenë të larmishme, p.sh., vlerësimi formues, i cili realizohet në mënyrë sistematike para ose gjatë mësimit, vlerësimi përmbledhës, i cili është testimi që zhvillohet në fund të një kapitulli, disa kapitujve, një semestri apo në fund të vitit dhe ka për qëllim vlerësimin e nivelit përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Përveç vlerësimit me gojë, formë mjaft e frytshme është dhe vlerësimi me shkrim ose me anë të testeve. Në testimin e njohurive dhe të aftësive në lëndën e biologjisë ka rëndësi që, përveç pyetjeve objektive, mësuesi të përdorë edhe pyetje të hapura.

Përcaktimi i blloqeve të përmbajtjeve lëndore që do të kontrollohen, sasia dhe niveli i pyetjeve, sistemi i pikëzimit dhe mënyra e konvertimit në notë për çdo test vendosen nga mësuesi.